

 PUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
926/20
Nr/Br. _____
Datë/Datum. 15.12.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr.926/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të Goran Milenković – Kryetar, Nuhi Paçarizi - Referues, Blerim Dina - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik “NAS SYSTEMS SH.P.K.” - Gjilan, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë operatorin ekonomik: D.P.T “Pro-Computers”- Gjilan, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Digjitalizimi i stacionit të autobusëve në Komunën e Gjilanit” me nr. të prokurimit: 651-19-7027-121, iniciuar nga AK – Kuvendi Komunal Gjilan, më datën: 15.12.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik “NAS SYSTEMS SH.P.K.” - Gjilan, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Digjitalizimi i stacionit të autobusëve në Komunën e Gjilanit” me nr. të prokurimit: 651-19-7027-121, iniciuar nga AK – Kuvendi Komunal Gjilan.

II. ANULOHET, njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Digjitalizimi i stacionit të autobusëve në Komunën e Gjilanit” me nr. të prokurimit: 651-19-7027-121, iniciuar nga AK – Kuvendi Komunal Gjilan, dhe lënda kthehet në **Rivlerësim**.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues “NAS SYSTEMS SH.P.K.” - Gjilan, aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Operatori ekonomik ankues OE “NAS SYSTEMS SH.P.K.” - Gjilan, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 12.11.2020 me nr. 926/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Digjitalizimi i stacionit të autobusëve në Komunën e Gjilanit” me nr. të prokurimit: 651-19-7027-121, iniciuar nga AK – Kuvendi Komunal Gjilan, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 7, 28, dhe 69 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 18.11.2020, ka autorizuar ekspertin profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti profesional i prokurimit në raportin e dt: 30.11.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

Sqarim hyrës: Ky aktivitet i prokurimit ka qenë objekt shqyrtimi në OSHP dhe se paneli shqyrtues lidhur me këtë aktivitet, për pretendimet e njëjta ka nxjerrë vendimin me numër 112/20.

Lidhur me këtë aktivitet të prokurimit janë nxjerrë edhe vendime tjera të sipërpërmendura, mirëpo, pretendimet e OE-së janë të njëjta me ato që janë shqyrtuar në vendimin numër 112/20 të datës 11.03.2020. Për më tepër, në sistemin e E-Prokurimit dhe nga AK, nuk janë paraqitur dokumente tjera të cilat mund të jenë kërkuar nga OE-të në bazë të dispozitave ligjore, gjatë fazës së rivlerësimit.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që bazuar në vendimin e OSHP-së nr. 112/20 të datës 11.03.2020, në bazë të rregullores së punës së OSHP-së (neni 16.3) kjo lëndë të konsiderohet si çështje e gjykuar më parë “res judicata” dhe

rrjedhimisht në bazë të këtij vendimi të OSHP-së, ankesa e OE ankues të aprovohet pjesërisht si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim, konform dispozitave të LPP-së.

Operatori Ekonomik, me datë: 30.11.2020, me anë të parashtrësës, ka njoftuar OSHP-në, se PAJTOHET plotësisht me mendimin e ekspertit shqyrtues

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 15.12.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit, dhe të gjithë parashtrësat e palëve në procedurë.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se ky aktivitet i prokurimit ka qenë objekt shqyrtimi në OSHP dhe se paneli shqyrtues lidhur me këtë aktivitet, për pretendimet e njëjta ka nxjerrë vendimin me numër 112/20. Lidhur me këtë aktivitet të prokurimit janë nxjerrë edhe vendime tjera të sipërpërmendura, mirëpo, pretendimet e OE-së janë të njëjta me ato që janë shqyrtuar në vendimin numër 112/20 të datës 11.03.2020. Për më tepër, në sistemin e E-Prokurimit dhe nga AK, nuk janë paraqitur dokumente tjera të cilat mund të jenë kërkuar nga OE-të në bazë të dispozitave ligjore, gjatë fazës së rivlerësimit.

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe sqarimeve të ekspertit shqyrtues, vjen në përfundim se për këtë çështje Paneli Shqyrtues ka nxjerr vendim më herët, ku pretendimet ankimore tanimë janë "res judicata". Pra, duke pasur parasysh faktin që për këtë çështje është vendosur më herët dhe pretendimet e OE-së janë të njëjta me ato që janë shqyrtuar në vendimin numër 112/20 të datës 11.03.2020, kurse AK në vendimin paraprak ishte obliguar AK që të kërkoj sqarime shtesë konform nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së duke bërë verifikimin e të gjitha dëshmimeve - dokumenteve që kanë të bëjnë me autorizimet dhe katalogët për të cilët i kishte kontestuar AK, me qëllim të vërtetimit nëse OE i rekomanduar përmbush kërkesat e specifikimeve teknike dhe kërkesat tjera të përcaktuara në dosje të tenderit. Mirëpo, në sistemin e E-Prokurimit dhe nga AK nuk janë paraqitur dokumente tjera të cilat mund të jenë kërkuar nga OE në bazë të dispozitave ligjore, gjatë fazës së rivlerësimit. Andaj, obligohet AK që të zbatoj udhëzimet e dhëna në vendimet e Panelit Shqyrtues dhe të bëjë vlerësimin konform këtyre vendimeve, të kërkoj sqarime shtesë konform nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së, si dhe në fund të bëjë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve në bazë të kërkesave të dosjes së tenderit dhe në harmoni me nenin 59 të LPP-së. Në të kundërtën,

AK e obligon Panelin Shqyrtues që të marr masa konform dispozitave ligjore kundrejt AK-së dhe zyrtarit përgjegjës të prokurimit.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.



Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK Kuvendi Komunal – Gjilan;
- 1x1 OE “NAS SYSTEMS SH.P.K.” – GJILAN;
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.